



**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**

---

**ADGJA.nr.05/2023**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**, Kryetari i Gjykatës Valon Totaj, duke vendosur përkitazi me ankesën disiplinore të parashtruar nga F.I. nga Peja, ndaj gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit, H.H., D.H. dhe M.N., lidhur me vendosjen në lëndën AA.nr.624/2022, të Gjykatës së Apelit në Kosovë, në kuptim të nenit 9, paragrafi 1.1 dhe 6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, me datën 01.06.2023, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa disiplinore e parashtruar nga F.I. nga Peja, ndaj gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit, H.H., D.H. dhe M.N., lidhur me vendosjen në lëndën AA.nr.624/2022, të Gjykatës së Apelit në Kosovë.

**A r s y e t i m**

Me datën 18.05.2023, përmes Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK), Gjykata e Apelit e Kosovës, e ka pranuar ankesën e ankuesit F.I. nga Peja. Parashtruesi në ankesë ka pretenduar se Gjykata e Apelit (kolegji i saj) ka marrë vendim jo kushtetues, për refuzimin e ankesës ligjore, për shkak të Komisionit për Shpronësimin e Pronës tek familja Islami dhe të pasurisë së F dhe M.I. po ashtu as të pjesëve të mbetura të pronës pas shpronësimit të pjesës së R dhe Sh.I. Parashtruesi i ankesës ka kërkuar që të përjashtojë gjyqtarët që kanë shkelur Kushtetutën e Kosovës, për të marrë një vendim të drejtë ligjor ndaj të njëjtëve. Gjithashtu në ankesë ka theksuar se si është e mundur që Gjykata e Apelit të ndërhyjë në procedurën ligjore për të cilën nuk ka pasur akt për marrjen e pasurisë së familjes Islami, më detalisht sikurse në ankesën e tij.

Kryetari i Gjykatës, pas pranimit dhe vlerësimit të ankesës, me datë 24.05.2023, nga kolegji gjyqësor i Gjykatës së Apelit në lëndën AA.nr.624/2022, në përbërje prej gjyqtarit H.H. – gjyqtar referues, D.H. dhe M.N. - anëtarë, ka kërkuar deklaram lidhur me ankesën e parashtruar nga ankuesi F.I..

Gjyqtari H.H., ka dhënë deklaratë me datën 26.05.2023, ku ka theksuar se shkresa nuk përmban identitetin e gjyqtarit, sipas Ligjit për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, konkretisht pikës 4, par. 4.2 të nenit 9, e gjithashtu shkresa nuk përmban një përshkrim konciz të aspekteve faktike dhe juridike mbi të cilat është ngritur dyshimi për shkelje disiplinore. Tutje gjyqtari H.H. ka theksuar se autoriteti kompetent nuk është kompetent për të vlerësuar se aktvendimi i marrë nga kolegji është jo kushtetues, sepse këtë e bënë Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, dhe atë pas kërkesës së këtu parashtruesit të shkresës, e më së paku këtë përfundim mund ta nxjerrë ankuesi, kur ka konstatuar në shkresë se *“Gjykata e Apelit e Kosovës ka marrë vendim jo kushtetues, për refuzimin e ankesës ligjore”*, andaj mbi bazën e të lartcekurave ka vlerësuar se shkresa e ankuesit F.I. nga Peja, duhet të hedhet poshtë, më detalisht sikurse në deklaratën e tij.

Gjyqtarja D.H., ka dhënë deklaratë me datën 26.05.2023, ku ka theksuar se sa i përket pretendimeve të palës, nuk ka se çfarë të deklarojë për arsye se sa i përket shkeljeve kushtetuese nëse pretendohet se ka pasur, atëherë kompetente për të vendosur për këtë çështje është Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, ndërsa pretendime të tilla nuk mendon se bëjnë pjesë në shkeljet disiplinore të gjyqtarit, sepse të njëjtit kanë të bëjnë me punën e tyre në kolegji duke vlerësuar dhe vendosur sipas ankesës së paditësit, në këtë çështje konkrete, andaj mbi bazën e të lartcekurave ka vlerësuar se një parashtrësë e tillë duhet të hedhet poshtë sepse nuk i plotëson kushtet që e njëjta të trajtohet si e tillë, më detalisht sikurse në deklaratën e saj.

Gjyqtari M.N., ka dhënë deklaratë me datën 29.05.2023, ku ka theksuar se vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimit gjyqësor në raport me Kushtetutën e bënë vetëm Gjykata Kushtetuese, andaj si e tillë kërkesa e ankuesit është e pabazuar, për shkak se i njëjti nuk ka parashtruar ndonjë provë konkrete me të cilin do të vërtetohej përgjegjësia eventuale disiplinore e gjyqtarit, andaj mbi bazën e të lartcekurave ka vlerësuar se në rastin konkret nuk është bërë as një shkelje disiplinore e gjyqtarëve, më detalisht sikurse në deklaratën e tij.

Kryetari i Gjykatës së Apelit, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, vlerësimin të pretendimeve ankimore dhe deklaratës së gjyqtarëve H.H., D.H. dhe M.N., ka gjetur se:

- ankesa e ankuesit F.I., është **e pabazuar.**

Kryetari i Gjykatës, pas shqyrtimit të ankesës së parashtruar nga ankuesi si dhe deklaratave të gjyqtarëve, vlerësoi se pretendimet ankimore sa i përket mënyrës së vendosjes, janë pretendime të pabazuara dhe të paqëndrueshme, për faktin se gjyqtarët janë të pavarur në vendimmarrje, pavarësi kjo e cila i’u është garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Po ashtu gjyqtarët janë të pavarur në punë e tyre, vendosin sipas ligjit dhe vendimet merren në bazë të provave që shqyrtohen dhe verifikohen në shqyrtim kryesor. Sipas vlerësimin të kryetarit, pavarësia

individuale, është pavarësia e gjyqtarëve në kryerjen e funksionit të tyre gjyqësor, që nënkupton se gjyqtarët duhet të jenë meritore, objektiv, neutral dhe të liruar nga çdo ndjenjë e ndikimit kur ushtrojnë funksionin e tyre gjyqësor.

Lidhur me pavarësinë në vendimmarrje nuk duhet të ketë asnjë ndërhyrje të pavend apo të pajustificuar në procesin gjyqësor dhe nuk duhet që vendimet gjyqësore të gjykatave t'i nënshtrohen ndryshimit. Në rastin konkret Kryetari i Gjykatës nuk ka kompetencë që të ndryshojë vendimet gjyqësore të nxjerra nga gjyqtari apo kolegji i gjyqtarëve dhe se pala e pakënaqur ndaj aktgjykimit të Gjykatës së Apelit nëse vlerëson se vendimi është marrë në kundërshtim me dispozitat kushtetuese, i njëjti eventualisht mund të parashtrijë kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, ndërsa nëse vlerëson se ka baza të tjera ankimore, atëherë i njëjti eventualisht mund t'i drejtohet Gjykatës Supreme.

Kryetari i Gjykatës vlerësoi, se në rrethanat aktuale të çështjes nuk ka bazë për të hapur një hetim disiplinor lidhur me vendosjen e çështjes së parashtruesit të ankesës, meqë me prova të shqyrtuara nuk është vërtetuar se gjyqtarët kanë bërë shkelje të Kodit të Etikës. Ndërkaq, për punën profesionale të gjyqtarit apo kolegjit, kompetent për vlerësim profesional është Komisioni për Vlerësimin e Performancës së Gjyqtarëve i cili vepron në kuadër të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Kosovës, ku i njëjti bën vlerësimin e performancës për gjyqtarët.

Gjithashtu në bazë të nenit 5 par.3 të Rregullores për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve nr.05/2019, të datës 27.05.2019, shprehimisht parashihet se *“çdo ankesë, edhe në qoftë se nuk shënohet shprehimisht si ankesë, do të konsiderohet si e tillë, kur nga përmbajtja del se qëllimi i palës është të paraqes një pretendim për shkelje disiplinore nga ana e gjyqtarit”*. Në rastin konkret kryetari i Gjykatës vlerëson se edhe pse ankesa në rastin konkret nuk i përmban elementet siç përcakton neni 5 i rregullores së lartcekur, e njëjta është trajtuar si e rregullt dhe pas konstatimit se kolegji gjykues me rastin e vendosjes në lëndën me numër AA.nr.624/2022, nuk ka bërë me shkelje disiplinore, e njëjta edhe është refuzuar si e pabazuar.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit në kuptim të nenit 9, paragrafi 1, pika 1.1. të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**ADGJA.nr.05/2023, me datë 01.06.2023**

**Kryetari i Gjykatës  
Valon Totaj**

***Vendimi t'i dorëzohet:***

- Parashtruesit të ankesës,
- Gjyqtarëve H.H., D.H. dhe M.N.,
- Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe
- Një kopje në shkresa të lëndës,